



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:057353

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06484215

KE.nr. 1184/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit Komuna e Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, kundër të paditurit “Kompania e Sigurimeve Sigkos” me seli në lagjen Kalabrija, kompleksi Riera, hyrja Z10, magjistralja Prishtinë-Shkup, me objekt kontestues pagesa e garancisë, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës më 21 nëntor 2024, gjykata mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Konstatohet e tërhequr padia e paditësit Komuna e Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmi, kundër të paditurit “Kompania e Sigurimeve Elsig” Sh.A me seli në Prishtinë, për shkak të pagesa e garancisë për ekzekutimin e kontratës.
- II. Secila e palë i bartë shpenzimet e veta procedurale në lidhje me këtë procedurë kontestimore.

ARSYETIM

Paditësi më 26.03.2021 ka ushtruar padi kundër të Paditurit, me të cilën i ka kërkuar kësaj gjykate të detyrohet i Padituri që në emër të garancisë me kërkesë të parë me numër të policës 060340020062937 lidhur me sigurimin e ekzekutimit të kontratës t’ia paguaj shumën prej 103,691.01€ me kamatë ligjore prej 8% nga data 02.11.2020.

Megjithatë, Paditësi përmes parashtresës së datës 13.11.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë e paraqitur më datë 26.03.2021.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në bazë të nenit 3 para. 1 lidhur me nenin 261 të LPK-së vendosi si në arsyetim të këtij vendimit.

Gjykata Komerçiale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1184/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.